REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE
17. 08. 2020
| Njësia org. / Org. Jedin. / Org. Unit | Shif.klasif. / Klasif. Kod / Class. Code | Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No. | Nr. Faqeve / Br. Stranica / No. Pages |
| --- | --- | --- | --- |
| 04 | 47 | 1471 | 8 |

REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
MUNICIPALITY OF GRAÇANICA
03 AUG 2020

**KOMUNA E GRAÇANICËS**

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit
Nga: Kryetari i Komunës së Graçanicës
Data: 30.07.2020
Graçanicë

## PLANI I VEPRIMIT

për eliminimin e mangësive dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e auditimit për raportin financiar vjetor të Komunës së Graçanicës për vitin 2019

Graçanicë, korrik 2020

## 3. Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raportii ZKA-së për auditimin për vitin 2019 kishte rezultuar me 9 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Komuna ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator 2019 dhe 15 mars 2020) sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit. Deri në fund të auditimit për vitin 2019, katër (4) rekomandime ishin zbatuar, tri (3) rekomandime janë konsideruar të mbyllura, ndërsa dy (2) rekomandime nuk ishin zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Për hir të qartësisë, si dhe mundësisë më të mirë për monitorimin e zbatimit të masave të dhëna, analizës së efekteve të tyre, të gjitha mangësitë, të gjitha masat për eleminimin e mangësive, si dhe personat përgjegjës dhe afatet për zbatimin e masave të dhëna do të tregohen në tabelë:

| Nr. | Gjetja | Rekomandimi | Masat për eliminimin e mangësive | Ekzekutuesit e masave të dhëna | Afati për eliminimin e mangësive |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në kategori jo adekuate ekonomike përmes planifikimit të buxhetit. Nga kategoria e investimeve kapitale për mallra dhe shërbime dhe anasjelltas janë paguar pagesat. Kjo çështje është trajtuar në raport nën nënkapitullin 2.1. | -Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestinim të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate. | Kryetari do të jetë i përkushtuar të sigurojë një analizë të hollësishme të të gjithë faktorëve që kanë ndikim në ekzekutimin e buxhetit, në mënyrë që të përmirësohet menaxhimi i shpenzimeve. | Zyrtari kryesor administrativ dhe ai financiar | 31.12.2020 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Shkaku përse ka ardhur deri tek kjo është mungesë adekuate e kontrolleve të brendshme në procesin e prokurimit si dhe arsyetimi nga ana e Komunës që të pranojnë mallra më cilësore ngase OE po ofertojnë me mallra të cilësisë së dobët. | | | | |
| 4. | Pasuritë kapitale dhe jo kapitale<br><br>Gjatë vitit 2019 komisioni për inventarizim të pasurive ishte formuar me vendim të kryetarit të komunës më datën 20.01.2020, mirëpo nuk kishte përgatitur ndonjë raport që tregon se është përfunduar ky proces si dhe njëherit mospërgatitja e këtij raporti reflekton tek prezantimi i pasurive tek PVF-të e komunës.<br><br>Shkaku përse ka ndodhur kjo është se komisioni nuk ishte në gjendje të ofroj dëshmi se ka përfunduar punën sipas kërkesave ligjore. | Kryetari duhet të siguroj që komisioni për inventarizim të pasurisë ka përfunduar punën duke hartuar raportin për inventarizimin e pasurive si dhe pastaj këtë ta harmonizoj me PFV e komunës. | Zyrtari kryesor administrativ, në bashkëpunim me Drejtorinë e Administratës, do të sigurojë që komisioni, pas kryerjes së detyrës, ta hartojë raportin për inventarizimin e pasurisë dhe ta harmonizojë me PVF-të e komunës. | Zyrtari kryesor administrativ<br><br>Drejtori i Drejtorisë së Administratës<br><br>Komisioni për Inventarizim | 31.12.2020 |
| 5. | Pasuritë kapitale dhe jo kapitale<br><br>Përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, moduli e-Pasuria ende është jo funksional. Të dhënat për | Kryetari, duhet të marrë veprimit e nevojshme për ta aplikuar sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria), në mënyrë që të ketë një menaxhimin dhe raportim të pasurisë | Në bashkëpunim me ministrinë kompetente, të eliminohen pengesat në funksionimin e Sistemit të Menaxhimit të Pasurisë (E-pasuria), në mënyrë që | Drejtori i Drejtorisë së Administratës<br><br>Zyrtari për Pasuri | 31.12.2020 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | arkëtueshme nga tatimi në prone pagesat e kryera për vitin 2019 e të cilat mund të jenë bartur në vitet paraprake dhe të shpërndara në emër të kamatave dhe ndëshkimeve.<br><br>Mosprezantimi i të arkëtueshmeve nga mbledhja e mbeturinave sipas zyrtarëve përgjegjës ka ndodh për arsye se ende nuk kanë një bazë të dhënash të saktë me fatura për secilën familje apo amvisëri, dhe se për këto të hyra lëshohen dëftesa. | | | | |
| 7. | Detyrimet e papaguara<br><br>Gjatë testimit kemi vërejtur se në 17 pagesa me vlerë 139,526€, faturat nuk janë paguar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat në pagesa janë nga 30 ditë e deri në 3 muaj.<br><br>Shkaku i mos pagesave me kohë ishin kontrollet e dobëta në zyrën e financave për të siguruar se ato kryhen me kohë. | Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat paguhen brenda afateve të parapara ligjore prej 30 ditësh. | Nëse në dispozicion janë mjetet e mjaftueshme në kategori të caktuara ekonomike, të gjitha faturat do të paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. | Zyrtari kryesor administrativ dhe ai financiar | 31.12.2020 |